



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria-Vlada-Government

Ministria e Tregtisë dhe Industrisë
Ministarstvo Trgovine i Industrije-Ministry of Trade and Industry



Agjencia Kosovare e Standardizimit
Kosovo Standardisation Agency
Kosovska Agencija za Standardizaciju

Raport i realizimit të planit të punës
AKS 2019

Planifikimi i planit të punës
AKS 2020

Përmbajtja:

1. Roli dhe rëndësia e standardizimit
2. Korniza ligjore e AKS
3. Këshilli Profesional i Standardizimit (KPS)
4. Komitetet Teknike (KT)
5. Standardet e adoptuara
6. Standardet e shfuqizuara
7. Standardet e shitura
8. Aktivitetet promovuese të AKS
9. Sistemi SMIS dhe ueb faqja e AKS
10. Buxheti i AKS
11. Grupe punuese/komisione
12. Raporte/kërkesa/takime
13. Trajnimet
14. Ngecjet në realizimin e aktiviteteve
15. Sfidat e standardizimit kosovar
16. Planifikimi i planit të punës AKS 2020

1. Roli dhe rëndësia e standardizimit

Agjencia Kosovare e Standardizimit (AKS), është institucion i cili siguron platformë për zhvillimin e standardizimit, duke mbështetur cilësinë dhe sigurinë e produkteve, proceseve dhe shërbimeve si dhe përhapjen e njohurive përmes standardeve, të cilat në mënyrë të vazhdueshme i zhvillon/adopton/miraton duke i dhënë prioritet atyre që kërkohen nga palët e interesit dhe që kanë më shumë ndikim në zhvillimin ekonomik të Kosovës. AKS zhvillon Standarde Kosovare për të gjitha palët e interesit dhe punon së bashku me rreth 150 ekspertë të fushave të ndryshme, të cilët aktivizohen në grupe punuese të Këshillit Profesional të Standardizimit dhe të Komiteteve Teknike.

2. Korniza ligjore e AKS

Baza ligjore e AKS tashmë është e kompletuar dhe e përafuar me acquis të BE, megjithatë janë edhe disa procedura të cilat duhet të plotësohen në formë të rregulloreve të brendshme.

Në këtë kuptim, korniza ligjore e AKS, është plotësuar me:

- a) Rregulloren e brendshme nr. 01-2019 për standardet e harmonizuara kosovare (19.04.2019); dhe
- b) Strategjinë Afatmesme të Agjencisë Kosovare për Standardizim 2020-2025 (15.10.2019).
- c) Marrëveshjen e Bashkëpunimit ndërmjet AKS-DPS (09.07.2019).
- d) Marrëveshjen Licencë ndërmjet AKS-CEN/CENELEC (01.01.2019-31.12.2019).

3. Këshilli Profesional i Standardizimi (KPS)

Këshilli Profesional i Standardizimit është trup këshillëdhënës, i cili funksionon në kuadër të AKS dhe si i tillë trajton programet e punës, përbërjen dhe drejtimin e Komiteteve Teknike. KPS mbanë takime të rregullta dy herë në vit, të cilat gjatë vitit 2019 janë mbajtur me 24.01.2019 dhe 27.06.2019, dhe i njëjti ka shqyrtuar raportin e punës dhe planin e punës për vitin 2019.

4. Komitetet Teknike (KT)

Komitetet Teknike janë grupe ekspertësh të deleguara nga institucione/organizata/biznese, të cilat veprojnë në fusha të caktuara të ekonomisë e që janë të përfshirë në procesin e standardizimit, respektivisht në hartimin dhe adoptimin e standardeve kosovare.

KT mblidhen në bazë të kërkesave nga palët e interesit dhe si të tilla gjatë vitit 2019 janë mbajtur gjithsej 30 takime në komitete teknike të ndryshme:

- metale, plastikë dhe elektrikë (1);

- pajisje personale mbrojtëse (2);
- teknologji informative (2);
- shëndetësi (2);
- makineri (3);
- transport dhe shërbime postare (4);
- përpunim i drurit (2);
- lodra, pajisje sportive dhe rekreacion (3);
- sisteme të menaxhimit të cilësisë (2);
- energji (2);
- ndërtim (2);
- metrologji (2);
- eurokode (1); dhe
- tekstil dhe lëkurë këpucë (2).

Është plotësuar/ndryshuar dhe menaxhuar në vazhdimësi lista me bazat deleguese të anëtarëve të të gjitha komiteteve teknike.


5. Standardet e adoptuara

AKS në vazhdimësi harton/adopton/miraton standarde të cilat janë me prioritet për ekonominë e vendit, industrinë dhe gjithashtu për plotësim të legjislacionit teknik me theks të veçantë për rregullore teknike të cilat i referohen standardeve.

Në total janë 454 standarde evropiane EN dhe ndërkombëtare ISO/IEC, të cilat janë adoptuar si standarde kosovare SK:

- ✓ KT për Energji (11 SK)
- ✓ KT për Makineri (54 SK)
- ✓ KT për Ndërtim (116 SK)
- ✓ KT për Shëndetësi (13 SK)
- ✓ KT për Metrologji (15 SK)
- ✓ KT për Përpunim Druri (43 SK)
- ✓ KT për Teknologji Informative (7 SK)
- ✓ KT për Tekstil dhe Lëkurë Këpucë (46 SK)
- ✓ KT për Pajisje Personale Mbrojtëse (15 SK)
- ✓ KT për Metale, Plastikë dhe Elektrikë (9 SK)
- ✓ KT për Transport dhe Shërbime Postare (83 SK)
- ✓ KT për Sisteme të Menaxhimit të Cilësisë (36 SK)
- ✓ KT për Lodra, Pajisje Sportive dhe Rekreacion (6 SK).

Tabela 1. Standardet e adoptuara



6. Standardet e shfuqizuara


Për të siguruar që standardet janë në fuqi, sekretarët e komiteteve teknike në vazhdimësi duhet t'i rishikojnë ato në një periudhë nga një deri në pesë vjet. Standardet mund të rishikohen edhe më shpejt me kërkesë të palëve të interesit, me informacionin për shfuqizim të marrë nga organizatat evropiane dhe ndërkombëtare të standardizimit, me ndryshimin e teknologjisë ose ndryshime tjera eventuale.

Në total janë 494 standarde evropiane EN dhe ndërkombëtare ISO/IEC, të cilat janë shfuqizuar:

- ✓ KT për Mjedis (4 SK)
- ✓ KT për Ndërtim (88 SK)
- ✓ KT për Makineri (27 SK)
- ✓ KT për Metrologji (15 SK)
- ✓ KT për Shëndetësi (26 SK)
- ✓ KT për Elektroteknikë (1 SK)
- ✓ KT për Përpunimin e Drurit (3 SK)
- ✓ KT për Teknologji Agroushqimore (1 SK)
- ✓ KT për Tekstil dhe Lëkurë Këpucë (25 SK)
- ✓ KT për Derivate të Naftës dhe Gazit (47 SK)
- ✓ KT për Pajisje Personale Mbrojtëse (45 SK)

- ✓ KT për Transport dhe Shërbime Postare (105 SK)
- ✓ KT për Sistemet e Menaxhimit të Cilësisë (64 SK)
- ✓ KT për Lodra, Pajisje Sportive dhe Rekreacion (43 SK)

Tabela 2. Standardet e shfuqizuara



7. Standardet e shitura

Standardet janë dokumente teknike të cilat zhvillohen në komitete teknike dhe pasi miratohen nga AKS bëhen publike për të gjitha palët e interesit. Çdo kush pastaj mund të blen standarde, e cila bëhet duke identifikuar standardet dhe dërguar kërkesën në adresën aksinfo@rks-gov.net, ose drejtpërdrejtë në zyrat e AKS ose edhe nëpërmjet telefonit, dhe në momentin kur konfirmohet pagesa e faturës, standardi bëhet i gatshëm për blerësin. Në total gjatë vitit 2019, janë shitur 123 standarde, në vlerën 2,311.00 €. Kryesisht këtë vit, standardet më të kërkuara kanë qenë ato të sistemeve të menaxhimit.

8. Aktivitete promovuese të AKS

Zhvillimi i mëtejshëm i politikave dhe programeve të AKS dhe rolit e rëndësishëm të standardeve dhe standardizimit kanë qenë dhe mbeten prioritet i AKS. Gjatë këtij viti AKS ka promovuar rolin dhe rëndësinë e standardeve:

- a) Prezantim i AKS për SHM Hoxhë K. Prishtina (11.09.19);

- b) Prezantim i AKS për SHM Hoxhë K. Prishtina (12.09.19);
- c) Prezantim i AKS për SHM Hoxhë K. Prishtina (26.09.19);
- d) Dita Botërore e Standardeve (16.10.19);
- e) Ligjëratë me studentët e Fakultetit të Inxhinierisë Mekanike/UP (25.11.2019);
- f) Ligjëratë me studentët e Kolegjit AAB (25.11.2019).
- g) Workshop me të gjithë Kryetarët e KT dhe KPS (26.11.2019).
- h) Përgatitje e materialeve promovuese: Katalogu i Standardeve Kosovare 2019.
- i) Inicimi i bashkëpunimit AKS-KIESA lidhur me promovimin e rolit dhe rëndësisë së standardeve dhe implementimi i tyre tek NVM.

9. Sistemi SMIS dhe ueb faqja e AKS

Sistemi SMIS është zhvilluar dhe plotësuar në vazhdimësi për nevojat e AKS dhe për të gjitha palët e interesit.

Ky sistem shfrytëzohet nga i gjithë stafi (7 sekretarët e komiteteve teknike) dhe përmban aktivitete si:

- Plotësime të SMIS me akte të reja ligjore.
- Identifikimi i materialeve në SMIS që nevojiten për ndryshime.
- Gabimet në futjen e të dhënave në SMIS.
- Plotësimet e referencave të standardeve.
- Plotësimet e “mirrore” të standardeve.
- Krijimi i user name dhe passwordit për palët e interesit.
- Krijimi i linçeve të reja në AKS ueb.
- Ndryshimet e strukturës vizuale të AKS ueb.
- Identifikimi i problemeve në SMIS, mos shfaqja e standardeve në ueb të AKS.
- Identifikimi i standardeve të cilat nuk përputhen me çmimet.
- Identifikimi i standardeve të cilat nuk kanë pdf file.
- Futja e të dhënave në data bazë dhe identifikimi i standardeve të dublikuara.
- Identifikimi i standardeve të shfuqizuara.
- Përpilimi i listave në Komitete Teknike me standarde të shfuqizuara.
- Përpunimi i fjalorit terminologjik të standardeve.
- Identifikimi i standardeve të harmonizuara.
- Download i standardeve (CEN/CENELEC iprojex).
- Krijimi i Back Up sistem.
- Përpilimi i planit lidhur me direktivat, lista me standarde të harmonizuara dhe filtrimit të tyre sa janë adoptuar nga AKS.
- Gjenerimi i “cover page” konform marrëveshjes së licencuar AKS-CEN/CENELEC.

10. Buxheti i AKS

Buxheti i AKS për mallra dhe shërbime është 35,233.00 €

Kategoritë ekonomike	Buxheti
Shpenzime të udhëtimit	7,250.00 €
Shërbime kontraktuese tjera	15,930.00 €
Shpenzime për anëtarësim	3,000.00 €
Botimet e publikimeve	6,751.00 €
Shpenzimet e përfaqësimit	2,302.00

Shpenzimi i buxhetit të vitit 2019 nuk është realizuar në shkallë të mjaftueshme, për shkak të standardeve që i marrim nga CEN/CENELEC pa pagesë, dhe mos anëtarësimit të AKS në ISO/IEC dhe CEN/CENELEC (shpenzime për anëtarësim). Gjithashtu, për shkak të vonesave në procedura nga Divizioni i Prokurimit dhe Kabineti i Sekretarit të Përgjithshëm të MTI, nuk janë realizuar disa aktivitete me ndikim buxhetor, si: furnizimi me kompjuterë për 4 zyrtarë të AKS; tenderi për materiale promovuese; dhe gjithashtu vizita/trajtime dhe workshopi i planifikuar në Tiranë është refuzuar nga ZKA; dhe vonesa tjera jashtë kompetencave të AKS.

11. Grupet punuese/komisionet

Zyrtarët e AKS kanë qenë mjaft të angazhuar nëpër grupe punuese dhe komisione të ndryshme brenda dhe jashtë AKS/MTI, si:

- Grupi punues për vlerësimin e kërkesave për vazhdim të autorizimit të trupave për vlerësim të konformitetit.
- Grupi punues në Këshillin Profesional të Akreditimit.
- Grupi punues për rregulloren e brendshme për standardet e harmonizuara kosovare.
- Grupi punues për hartimin e strategjisë së AKS 2020-2025.
- Grupi punues: Plani kombëtar për rritjen e numrit të ndërtesave me konsum afër zero-energji 2019-2021, dokument i përkrahur nga projekti GFA-Komisioni Evropian, bartës Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.
- Grupi punues ndërmintor për Draft Udhëzuesin për Vendosjen e Kërkesave Minimale të Performancës Energjetike për Projektuesit e Ndërtesave dhe Pronarët e Ndërtesave (MMPH).
- Grupi punues ndërmintor për hartimin dhe finalizimin e Projektligjit për Plotësimin dhe Ndryshimin e Ligjit Nr. 04/L-004 për Shërbimet Private të Sigurisë.
- Grupi punues për hartimin e draftit të Rregullores Teknike për Pajisje Personale Mbrojtëse.
- Grupi koordinues ndërmintor për kapitullin 1: Lëvizja e Lirë e Mallrave.

➤ Grupi punues për plotësim/ndryshimin e udhëzimit administrativ nr. 16/2012 “cilësia e ujit për konsum nga njeriu”.

➤ Grupi punues për hartimin e udhëzimit administrativ për kërkesat themelore për punimet e ndërtimit, deklaratën e performancës së produkteve të ndërtimit, sistemet e vlerësimit dhe verifikimit të qëndrueshmërisë së performancës të produkteve të ndërtimit dhe publikimin e deklaratës së performancës në ueb faqe.

➤ Grupi punues për hartimin e rregullores për sigurinë e makinerive.

➤ Komisioni për ankesa dhe parashtrës.

➤ Komisioni për rekrutim: Zyrtar për Metrologji.

➤ Komisioni për rekrutim: Zyrtar për Promovim të Standardeve.

➤ Komisioni për rekrutim: Zyrtar i Lartë për Teknologji Informative.

➤ Komisioni për vlerësimin e kushteve për emërimin e trupave për vlerësim të konformitetit për mjetet matëse në qendrat e kontrollimit teknik të automjeteve.

➤ Komisioni për vlerësimin e kushteve për emërimin e trupave për vlerësimin e konformitetit për cilësinë e karburanteve të lëngëta të naftës.

➤ Komisioni për vlerësimin e kushteve për emërimin e trupave për vlerësimin e konformitetit për ashensorë;

➤ Komisioni për pranim/dorëzimin e rezervave shtetërore të grurit.

➤ Komisioni për vlerësimin e dëmeve të shkaktuara në Objektivin e Industrisë Kimike në Bërnice.

➤ Komisioni për vlerësimin e ofertave: “Furnizim me material promovues për AKS”.

➤ Menaxhimi i kontratës: “Sigurimi i Objekteve të MTI (“Rosa Security” SHPK).

12. Raporte/kërkesa/takime

AKS në vazhdimësi bënë raportim në baza të rregullta (javore, tremujore dhe vjetore) dhe shqyrtim të kërkesave për të gjitha palët e interesit, si:

➤ Raport për Inputet II për Raportin e KE për Kosovën 2019;

➤ Raporte mujore për zyrën e prokurimit;

➤ Raporte për PKZMSA;

➤ Raporte dhe plani i punës për KPS;

➤ Raporte lidhur me adoptimin e standardeve për kabinetin e Ministrit dhe Sekretarin e Përgjithshëm;

➤ Raporte tre mujore për aktivitetet e AKS (Departamenti i Integriteteve);

➤ Plotësim i planeve për Projektin e Luksemburgut dhe definimin e prioriteteve të cilat do të financohen për vitin 2019 “OIP-Chapter 1-Free Movement of Goods”;

➤ Raport për LuxDev, lidhur me eurokodet dhe anëtarët e KT për Eurokode;

- Raporte mujore për zyrën e prokurimit lidhur me OE “Rosa-Security”;
- Raporte e të hyrave të AKS për zyrën e financave;
- Raporte e të hyrave të AKS për zyrën e auditimit;
- Raport lidhur me identifikimin e akteve ligjore për Planin e Veprimit për Fushën e Pa-harmonizuar;
- Raport për Programin për Reforma në Ekonomi.
- Përgatitja e Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve për periudhën 2020-22;
- Planifikimi i prokurimit AKS 2019;
- Planifikimi i të hyrave vetanake të AKS për 3 vitet e ardhshme (AKS 2020-2022);
- Përgatitja e propozimit për Projektin e PTB;
- Plotësimi i Matricës: MTI Prioritetet;
- Dy “steering committee” të udhëhequra nga Drejtori i Përgjithshëm i AKS, lidhur me Projektin e Qarkullimit të Lirë të Mallrave FMG II;
- Pjesëmarrje në Konventën e Industrisë së Drurit;
- Pjesëmarrje në Ditën Botërore të Akreditimit;
- Pjesëmarrje në Ditën Botërore të Metrologjisë.

Gjithashtu, AKS ka shqyrtuar shumë kërkesa të ndryshme të palëve të interesit, si: “Tetë Vëllezërit” SHPK; Instituti “INKOS”; “Tre Pharm” SHPK; Agjencia Kosovare për Forenzikë; Divizioni për Infrastrukturë të Cilësisë; “Euro Inspect”; MZHE; Projekti FMG II; “E&A Engineering Consulting” SH.P.K.; “Graniti” SHPK; “Eramed”; “KEDS”; “Pasha Inspect”; Hekurudhat e Kosovës; Inspektorati/MTI; “ISeferi”; Drejtoria e Akreditimit; Departamenti për Regjistrimin e Automjeteve; “Europe Systems L.L.C”; Departamenti Special Anti Korrupsion; “Burimi Commerce”; Personi Fizik Azdren Doli, dhe Arta Sylejmani (Doktorante e Universitetit të Zagrebit); “Dekor”; IMN Test Beton; “Golden Consulting Centre” SH.P.K; “Inxhiniering Test”; “Fatjoni”; “A&F CONSTRUCTION”; “Thermo”; “Sharr-Cem”; Kolegji “UBT” (Universiteti për Biznes dhe Teknologji); “Natyra CH4”; Agjencia për Kontroll të Produkteve Medicinale; Laboratori “ETL”; “HD Pellet”; “Arbor” SHPK; “Infra Plus” SHPK; “IBMS” NSH; “Valdrini”; “Zhurma” NSH; “Geo Mjedisi”; “Medi Lab”; “HILL International”; KEK; “Eurosistem”; “Gjeotekstili”; “Studio Cena”; Trepça; Policia e Kosovës; SHPK “Ballkan 1”; Instituti Bujqësor i Kosovës; N.T.SH. ”KG-Engineering”; “Renelual Tahiri”; Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë së Kosovës; IKSHP; Doganat e Kosovës; KIESA lidhur me certifikimin e produkteve (verifikimi i certifikatës), Zyra Kombëtare e Auditimit; IMK Steel Construction; NPSH ”Extra Colors”, etj.

13. Trajnimet

- ✓ Trajnim lidhur me kornizën ligjore të AKS.
- ✓ Trajnim lidhur me databazën SMIS.
- ✓ Trajnim me standardin ISO/IEC 17065.
- ✓ Trajnim me programin SQL/IT.
- ✓ Trajnim për Microsoft Excel 2013.
- ✓ Trajnim për komunikim qeveritar në media.
- ✓ Trajnim për reforma në administratë publike-risitë dhe ndryshimet ligjore.
- ✓ Trajnim për hartimin e legjislacionit.
- ✓ Trajnim i Trajnerëve për Kapitullin I: Lëvizja e lirë e mallrave.
- ✓ Trajnim për TVK (laboratorë testues/certifikues).
- ✓ Asambleja Gjenerale e CEN/CENELEC.
- ✓ StandarDays CEN/CENELEC.
- ✓ Konferenca Ballkanike e Standardizimit.
- ✓ Standardet e harmonizuara dhe rregulloret teknike.
- ✓ Notifikimi, promovimi dhe SMIS i standardeve.
- ✓ Kursi i gjuhës angleze.

14. Ngecjet në realizimin e aktiviteteve

→ Mos anëtarësimi në CEN/CENELEC

Në pamundësi për të qenë anëtarë në organizatat evropiane dhe ndërkombëtare të standardizimit, AKS furnizohet me standarde EN nga një marrëveshje licencë që ka nënshkruar me CEN/CENELEC, mirëpo e njëjta duhet të avancohet edhe më tej në mënyrë që të përshpejtohet dhe të funksionalizohet plotësisht sigurimi i standardeve.

→ Databaza SMIS

Databaza duhet patjetër të plotësohet (update) dhe të ketë mundësi kontrolli të plotë nga AKS. Aktualisht ajo plotësohet/ndryshohet vetëm nga Ekspertë të Projektit FMG II. Update i SMIS me CEN/CENELEC është gjithashtu çështje urgjente e cila duhet të rregullohet.

→ Shitja on-line e standardeve

Është mundur vetëm porosia on-line e standardeve, ndërsa standardet nuk shiten on-line si pasojë e sistemit bankar por edhe për arsye të “copy right of standards” (nuk kemi një program për të mbrojtur standardet nga kopjimi).

→ Përgatitja e standardeve për shitje

AKS ka probleme të vazhdueshme me përgatitjen e standardeve për shitje. Edhe pse ne kemi në pronësi një fotokopje shumë të mirë dhe cilësore të modelit SHARP, megjithatë e njëjta nuk mund të servisohet për arsye se me kontratën e re të MTI, e gjithë administrata ka vetëm fotokopje të modelit RICOH, dhe fotokopjen SHARP nuk e

mirëmbajnë më. Fotokopja RICOH, nuk funksionon, printon/kopjon aspak me cilësinë e duhur dhe gjithashtu fletët e printuara/kopjuara i deformon fizikisht.

→ Vulosja e standardeve

Standardet të cilat AKS i përgatit për shitje duhet të vulosen, dhe meqenëse AKS nuk ka vulë të sajën, ne detyrohemi të dërgojmë standardin për vulë në Kabinetin e Ministrisë. Kjo procedurë shkakton punë dhe kohë shtesë dhe gjithashtu vonesë për klientin.

→ Kapacitetet e stafit

Referuar zhvillimeve të vazhdueshme të standardizimit në nivel evropian dhe ndërkombëtar, stafi ka pak njohuri në gjuhën angleze, dhe aplikimin e databazës SMIS.

→ Ngritja e kapaciteteve

Edhe pse buxheti aktual i AKS për realizimin e vizitave studimore/udhëtime zyrtare/trajtime është relativisht i vogël, megjithatë ato që janë planifikuar janë refuzuar nga ZKA ose janë realizuar me shumë vështirësi.

→ Kompjuterë dhe UPS

Janë katër kompjuterë të cilët pas vlerësimit nga IT janë konstatuar se duhet të zëvendësohen me të rijë, ndërsa pajisje për ruajtjen e energjisë nuk kanë asnjë zyrarë të AKS. Edhe pse disa herë janë bërë kërkesa, madje edhe kërkesa me zotim të mjeteve për tu pajisur me kompjuterë dhe UPS, por nga DFSHP dhe ZKA nuk janë realizuar.

→ Materialet promovuese

Materialet promovuese të planifikuara për AKS nuk janë realizuar për arsye të kontraktorit i cili në katalogun e tij nuk ofron produkte cilësore, por edhe si pasojë e procedurave komplekse të prokurimit.

15. Sfidat e standardizimit kosovar

Ndërtimi i Sektorit të Certifikimit në AKS. Fuqizimi i ligjit, duhet të pason me një UA për certifikim, për të cilin duhet mirëkuptim i MF. Certifikimin e ka rekomanduar Komisioni Parlamentar si domosdoshmëri kohe, ndërsa AKS pritët ta zhvillon këtë sektor. Gjithashtu, janë edhe disa rregulla dhe procedura të standardizimit të cilat duhet të hartohen konform ligjit të ri për standardizim.

- Ngritja e Sistemit të Menaxhimit për Agjencinë (AKS) mbetet sfidë tjetër e cila duhet të realizohet.
- Ngritja e një pike ose qendre të informacionit për standarde (Info Centre) për të gjitha palët e interesit, mbetet të realizohet.
- Anëtarësimet në organizatat evropiane dhe ndërkombëtare, nuk janë realizuar, për shkak politikë. AKS ka kërkuar nga CEN/CENELEC një qasje në standardet EN me ç'rast është propozuar një "Marrëveshje e Licencuar".
- Krijimi i grupeve punuese (nën komiteteve teknike) për eurokode dhe hartimi i anekseve kombëtare.

16. Planifikimi i planit të punës AKS 2020

- Hartimi i rregulloreve të brendshme lidhur me rregullat dhe procedurat për hartimin, njohjen, adoptimin, miratimin dhe publikimin e standardeve evropiane dhe kosovare; si dhe për marrëveshjet e licencimit ndërmjet AKS dhe CEN/CENELEC për miratimin e standardeve evropiane.
 - Implementimi i strategjisë AKS 2020-2025 dhe kornizës ligjore të AKS.
 - Plotësime të dokumentacionit/vendimet për adoptim dhe shfuqizim të SK.
 - Menaxhimi i Marrëveshjes Licencë AKS-CEN/CENELEC.
 - Menaxhimi i Marrëveshjes së Bashkëpunimit AKS-DPS.
 - Menaxhimi dhe funksionalizimi i Databazës SMIS dhe WEB.
 - Organizim i takimeve të Këshillit Profesional të Standardizimit.
 - Organizim i takimeve të Komiteteve Teknike.
 - Adoptimi i rreth 500 standardeve të reja.
 - Shfuqizimi i rreth 500 standardeve të vjetra.
 - Përgatitja e materialeve promovuese.
 - Organizimi i Ditës Botërore të Standardeve.
 - Organizimi i 15 vjetorit të themelimit të AKS.
 - Pjesëmarrje në asambltetë e përgjithshme të organizatave evropiane dhe ndërkombëtare dhe pjesëmarrje në iniciativat rajonale dhe evropiane të standardizimit.
- Realizim i takimit me përfaqësues të CEN/CENELEC dhe ISO/IEC lidhur me mundësinë e bashkëpunimit AKS-CEN/CENELEC-ISO/IEC.
 - Ngritje e kapaciteteve të AKS.
 - Konsulencë për palët e interesit mbi implemtimin e standardeve.
 - Shërbim i palëve të interesit me standarde.
 - Rritje e bashkëpunimit me të gjitha ministritë e linjës dhe institucione tjera që i referohen standardeve.
- Rritje e bashkëpunimit me të gjithë të interesuarit (Universitete; KIESA; OEK; OEA, etj.) lidhur me sesione informative për rolin dhe rëndësinë e standardeve, etj.